

EDUKIMI NDËRKULTUROR: NJË DIMENSION TRANSVERSAL NË DIDAKTIKËN E GJUHËVE TË HUAJA

Prof. asoc. Dr. AIDA GJINALI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
aida.gjinali@unitir.edu.al

Msc. ELIONA NAQO (ÇELOALIAJ)

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë
Universiteti Ismail Qemali
naqo.eliona@gmail.com

ABSTRACT

The purpose of the paper is to point out the importance of culture in foreign language learning from the point of view of an intercultural perspective. Access between different cultures is a key factor in an appropriate teaching of one language or many eyes and not only, but also in the formation of such intercultural communicative competences as enable an appropriate intercultural formation and development in the great global village in which we live.

It is already known that learning a foreign language cannot be separated from learning the culture of the people who use it. In fact, language is not an abstract tool consisting only of morphosyntactic rules and constructions but is supported by a specific culture that manifests itself through it. Based on human history, we already know how culture affects a respective language by coloring it with linguistic phenomena unknown in other languages, since a certain cultural phenomenon has a linguistic variety as a response to describe it and even often this constitutes a problem both linguistic and cultural.

In the same way, we can say that culture does not exist or is not talked about without considering the language tool. A culture is described through it, and a certain variety of words serve to describe a certain phenomenon. This

is also the challenge that a foreign language teacher must face every time to find the right methodology for the student's approach. An approach known as the Intercultural Approach offers the right strategies for the development of intercultural communication competence, an objective that is already necessary to be achieved and put in the main focus by European policies with the aim of multilingual and intercultural education of young generations and the creation of a open mindedness and acceptance of other's diversity.

Keywords: intercultural education, culture, language, competence, communication.

1. Gjuhë & kulturë

Boas e përkufizoi kulturën si “tërësi e reagimeve dhe aktiviteteve intelektuale dhe fizike që karakterizojnë sjelljen e individëve që përbëjnë një grup shoqëror”¹.

Njeriu është një krijesë shoqërore që merr, komunikon, mbledh dhe shpërndan informacione² në mënyrë të vazhdueshme, pasi vetëm në këtë mënyrë qeniet njerëzore mund të bashkëveprojnë dhe evoluojnë në zhvillimin e tyre të përgjithshëm dhe të ecin në mënyrë progresive përpara. Realizimin e gjithë kësaj njeriu e mundëson nëpërmjet gjuhës. Në fakt është e vetmja qenie që ka aftësinë të përcjellë kumte e të shprehet në mënyrë verbale dhe jo vetëm. Kjo bëhet për të arritur qëllime apo objektiva të lidhura ngushtë me kontekstin duke përfshirë këtu bashkëbiseduesin, moshën, hierarkinë, shkallën e njohjes, etj. Komunikimi realizohet dhe përcillet në formën e përcaktuar sipas nevojës dhe nëpërmjet kanalit të përzgjedhur me qëllim realizimin përfundimtar të tij. Në ligjërime çdo njeri përfshin mendimin e tij i cili pasqyrohet nëpërmjet gjuhës që mbart gjithashtu edhe kulturën përfaqësuese të asaj gjuhe dhe të atij individit. Të ndërlidhura së bashku mendimi, gjuha dhe kultura, ku njëra nuk mund të mendohet e shkëputur nga tjetra, jetojnë, bashkëveprojnë, rriten dhe evoluojnë si një organizëm i vetëm dhe mundësojnë bashkëveprimin në çdo kontekst komunikues.

¹ Giaccardi C. (), La comunicazione interculturale, Mulino 2005, fq. 22.

² Greimas, A. J. (1970). Les proverbes et les dictons. Du sens, 1, fq. 309-314.

Sapir³ pohon se çdo model kulturor dhe çdo akt i vetëm i sjelljes shoqërore përfshin komunikimin në kuptim të drejtpërdrejtë ose jo dhe mjeti për këtë komunikim është gjuha, ndaj dhe njohja e njërës sjell detyrimsht dhe njohjen e tjetrës.

Mësimi i një gjuhe të huaj nuk do të thotë të mësosh diçka abstrakte pra vetëm rregulla, kuptime, struktura etj., pasi mësimi i një gjuhe ngërthen padyshim edhe kulturën e saj, të cilën duhet t'ia përcjellim nxënësit në mënyrë të tillë që ai të formohet nga ana gjuhësore në mënyrë domethënëse. Të zotërosh një gjuhë, do të thotë të dish ta përdorësh atë në çfarëdo lloj situatë dhe konteksti komunikues në të cilën ajo paraqitet, pra pashmangshmërisht duhet të kesh në konsideratë kulturën e asaj gjuhe dhe kombin që e përfaqëson atë.

Gjuha është mjet komunikimi ndaj në njohjen e një gjuhe të huaj do të thotë të komunikosh me një komb që e përdor atë gjuhë dhe përfaqësohet prej saj në jetën e përditshme dhe që e përdor atë për t'u shprehur dhe zgjidhur nevojat që ka. Por ky mjet komunikimi ka të ndërthurur brenda tij kulturën e atij kombi, kulturë e cila e ka pasuruar dhe i ka dhënë asaj ngjyime që janë të ndryshme nga ato të një gjuhe të një kombi tjetër. Ndaj dhe qëllimi i edukimit ndërkulturor qëndron pikërisht tek fakti i njohjes jo vetëm i aspekteve kulturore që një gjuhë mbart por edhe atyre ngjyimeve që e zbukurojnë dhe e ndërlikojnë atë.

2. Gjuha dhe mjedisi

E dimë sipas hipotezës së Sapir dhe Whorf⁴ që gjuha është shprehëse e mendimit njerëzor, mendim ky i cili është i mbrujtur dhe i formuar që në fëmijëri nga familja, komuniteti, shkolla, shoqëria etj. Të gjithë këta faktorë që ndikojnë në formimin e një personi, ndikojnë në konceptin e tij të menduarit të botës dhe në mënyrën e të shprehurit dhe të komunikimit me të tjerët. Kjo hipotezë, në fakt, sugjeron që një gjuhë përcakton dhe zgjidh mendimin dhe perceptimin e folësve të saj. Në

³ Sapir, E. (1921). Language. New York: Harcourt Brace, fq 104

⁴ Op. Cit.

kuptimin që asnjë gjuhë nuk mund të mbijetojë përveçse në kontekstin e kulturës dhe reciproke, kultura që nuk ka në qendër strukturën e një gjuhe standarde dhe të zakonshme nuk mund të mbijetojë.⁵

Nga studimet e ndryshme antropo- sociologjike ajo çfarë evidentohet është fakti që gjuha nuk mund të konsiderohet si diçka artificiale dhe si diçka e ndarë dhe e veçuar nga kultura, pasi gjuha dhe kultura ndikojnë në mënyrë të vazhdueshme tek njëra tjetra dhe lidhen ngushtë me pasqyrimin e realitetit, mjedisit ku ajo jeton dhe përdoret dhe nevojave të një kombi.

Për të kuptuar se sa gushtësisht gjuha është e lidhur me vendin ku ajo përdoret, Boas⁶ thotë që fjalët e një gjuhe përshtaten me mjedisin në të cilin përdoren. Në fakt nëse do të shihnim se si një fenomen pasqyrohet nga njëri vend në tjetrin do të verifikonim trajta gjuhësore dhe kuptimore të cilat mund të jenë jo vetëm të ndryshme por edhe mund të mungojnë krejtësisht në një vend tjetër, pasi pasqyrojnë fenomene të cilat mund të jenë më pak të rëndësishme ose aspak në një vend tjetër. Kjo do të thotë që paraqesin aspekte kulturore të asaj gjuhe lidhur me mjedisin jetues krejt të ndryshme të një kombi nga një tjetër dhe njohja e gjuhës së atij kombi nënkupton njohjen e një kulture e cila mund të jetë krejtësisht e ndryshme nga ajo e jona.

Kështu p.sh. në vendet arktike⁷ duke iu referuar fenomeneve atmosferike mjaft karakterizuese të këtyre vendeve dhe në shtrirje pothuaj gjithëvjetore: si erë, akull, stuhi, etj, ekziston një numër i jashtëzakonshëm fjalësh për t’i përcaktuar ato sipas karakteristikave gjë që për vende të tjera ku këto fenomene janë të panjohura dhe të pakuptueshme ose nuk janë në të njëjtën shkallë është e qartë që edhe në gjuhën përkatëse ato nuk janë të pasqyruara ose janë fare pak. Kjo tregon sesa një gjuhë pasurohet në ambientin në të cilin ajo jeton dhe sesi ajo krijon dhe rikrijon brenda dhe jashtë saj vazhdimisht terma e shprehje për t’iu përshtatur fenomeneve apo nevojave të reja gjuhësore që lindin si rrjedhojë e nevojave të një kombi.

⁵ Whorf, B. L. (1956), *Language, Thought, and Reality: Selected Writings of Benjamin Lee Whorf*, John B. Carroll (ed.), ed., MIT Press.

⁶ Boas, Franz 1964 [1911]. *Questioni fondamentali dell’antropologia culturale [The mind of primitive man]*. Buenos Aires: Solar/Hachette

⁷ Harrison K. D. (2010), *The Last Speakers: The Quest to Save the World’s Most Endangered Languages*, National Geographic.

Një nevojë e tillë e vazhdueshme vihet re sidomos në kohët tona moderne ku zhvillimi dhe përparimi galopant e frenetik në çdo fushë të jetës lidhur veçanërisht me teknologjinë kërkon vazhdimisht emërtimin e fenomeneve shoqërore, politike, ekonomike, sociale, kulturore që lindin si rrjedhojë e asaj që kërkon vetë koha.

Jo më larg se një vit më parë mendjet tona dhe komunikimi ynë u dyndën dhe u bombarduan me informacione të reja konceptuale dhe terminologji nga ato më specifike mjekësore deri tek më të thjeshta si: Coronavirus, pandemi, maska kirurgjikale, PPF2, tampon seriolgjik, karantinë, antikorpe, variant, mutacion, oksimetër, distancim social, etj. Sigurisht që një pjesë e tyre ishin mjaft të njohura dhe të ditura në ambientet profesionale mjekësore por të panjohura ose shumë pak të njohura nga pjesa më e madhe e popullsisë që as kishte dëgjuar dhe as që kishte për t'i mësuar nëse fenomeni nuk do të shfaqej. Sigurisht, ky që një fenomen mbarëbotëror dhe jo i një kombi të veçuar dhe nuk përfaqëson asnjë komb në veçanti, por fenomeni që i tillë që gjeneroi përdorim e një terminologjie të caktuar në një periudhë të caktuar kohore.

Në këtë mënyrë kuptojmë se si kultura ka ndikuar në gjuhë: një fenomen i caktuar kulturor ka një larmi gjuhësore si përgjigje për ta përshkruar atë. Nga ana tjetër, mjeti gjuhësor ndikon në kulturë: një larmi e caktuar fjalësh përdoret për të përshkruar një fenomen të caktuar.

Në thelb, kultura konsiderohet si një repertor i besimeve, përvojave, praktikave dhe vlerave të përbashkëta që përdoren nga një grup njerëzish për të kuptuar botën që i rrethon⁸, ndaj dhe nëse duam që ta njohim këtë grup dhe të komunikojmë me të lind nevoja e njohjes së tyre dhe kjo jo vetëm në aspektin gjuhësor – kulturor por edhe atë njerëzor.

Kështu, ata që janë gati të mësojnë një gjuhë të ndryshme nga e tyreja, duhet të mësojnë gjithashtu një kulturë të ndryshme, domethënë, duhet të kuptojmë një varësi të caktuar të dy faktorëve dhe për këtë arsye të arrihet në përfshirjen e kulturës në studimin e një gjuhe.

⁸ Nasir, N., Hand, V. (2006). Exploring sociocultural perspectives on race, culture, and learning. Review of Educational Research, 76, fq. 449-475

Në komunikimin e ndërsjellë që kemi me të tjerët ne marrim në mënyrë të vetëdijshme apo shpesh të pavetëdijshme koncepte, shprehje, forma, idioma gjuhësore të të tjerëve, të cilat i huazojmë duke i përdorur për ndonjë periudhë kohore të caktuar sipas nevojave, të tjera që i interiorizojmë, transformojmë e përshtatim dhe i bëjmë tonat si mjet për përmbushjen e nevojave tona dhe bashkë me to aspekte kulturore të asaj gjuhe, sepse e kemi konsideruar, vlerësuar, pranuar dhe bërë pjesë të gjuhës dhe kulturës tonë.

Pra, nëse do i referoheshim konceptit të disa festave që tashmë kanë hyrë dhe janë bërë pjesë deri diku e kulturës tonë, do vinim re që festa si Shën Valentini, apo Halloween janë festa që kanë hyrë vonë tek ne, pas viteve 90, atëherë kur dëshira e një populli të mbajtur gjatë mbyllur ishte ajo e imitimit dhe huazimit të çdo lloj gjëje të huaj dhe si rrjedhojë dhe e këtyre festave si fenomen kulturor. Gjithashtu edhe festa me karakter më të ngushtë familjar që dikur nuk ekzistonin si *babyshower*, *gender reveal*, propozime publike për martesë etj., janë huazuar dhe tashmë kanë hyrë dhe janë bërë pjesë e kulturës pavarësisht që janë përqaftuar vonë. Bashkë me anën formale të realizmit të tyre kanë hyrë në përdorim edhe forma gjuhësore të huaja, kryesisht amerikane, që lidhen ngushtë me to. Fenomeni i përdorimeve të festave të huaja dhe shprehive gjuhësore të huaja sigurisht është një argument tjetër shumë i rëndësishëm për t’u analizuar por jo në këtë kumtesë.

3. Edukimi ndërkulturor

Para se t’i referohemi konceptit të edukimit ndërkulturor është e nevojshme të kuptojmë se çfarë do të thotë edukim.

Edukimi është një fakt thelbësor për jetën e njeriut. Ai realizohet, edhe pse në forma të ndryshme tek të gjithë popujt dhe në të gjitha kohërat, ku të rriturit përpiqen të përcjellin tek brezat e rinj zakonet, ritet, parimet, njohuritë që kanë nga përvoja e përbashkët duke e ushqyer dhe paraqitur si të domosdoshme për të marrë pjesë në mënyrë efektive në jetën e komunitetit.⁹

⁹ Mencarelli, M., (1970), *La struttura del discorso pedagogico*, Pro-Manuscripto, Arezzo. fq. 3

¹⁰ Balboni P.E. (1994), “*Didattica dell’italiano a stranieri*”, Bonacci editore, Roma, Fq 21

Edukimi është procesi i studiuar nga shkencat pedagogjike në të cilin mundësohet të dalë në pah, ajo që subjekti ka si potencial për vetëzhvillimin pra (vetëpromovim), për marrëdhëniet me të tjerët (socializimin) dhe lidhur me me mjedise të tjera kulturore (kulturim).

10

Në këndvështrimin antropologjik-kulturor edukimi është një proces që synon humanizimin e njeriut dhe që realizohet me dhe ose pa qëllim, me modalitete të diferencuara, shpesh të kushtëzuara nga kultura në të cilën zhvillohet, në koherencë me vizionin që ka qenia njerëzore, potencialin e saj, vlerën dhe qëllimet të cilat mund të arrihen.

Pluralizmi i konceptimeve për njeriun dhe shumëfishimi i modeleve kulturore përcaktojnë poliseminë e fjalës *edukim*, përdorimi i së cilës është i lidhur me pritshmëri të diferencuara që nuk e lehtësojnë propozimin e një përkufizimi të vetëm të termit, të aftë të përfaqësojë pasurinë dhe shumëllojshmërinë e kuptimeve të tij.

Në lidhje me konceptin e edukimit ndërkulturor thuhet që ai përforcon kuptimin e demokracisë, duke pasur parasysh se “diversiteti kulturor” duhet të konsiderohet si një burim pozitiv për proceset komplekse të rritjes së shoqërisë dhe individëve. Prandaj, objektivi parësor i edukimit ndërkulturor përvijohet si promovimi i kapacitetit për bashkëjetesë konstruktive në një strukturë shumëplanëshe kulturore dhe sociale. Ai përfshin jo vetëm pranimin dhe respektimin e të ndryshmëve, por edhe njohjen e identitetit kulturor, në kërkimin e përditshëm të dialogut, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit, në një perspektivë pasurimi reciprok.¹¹

4. Mësimi i një kulture të huaj

Të mësuarit e një kulture të huaj mundësohet nëpërmjet një kontakti të vazhdueshëm dhe gradual në klasat e gjuhës së huaj. Kjo njohje graduale realizohet në shtrirje në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë të tillë që procesi mos krijojë refuzim psikologjik të saj apo

¹¹ Qarkore Ministrisë (1990) - https://www.edscuola.it/archivio/norme/circolari/cm205_90.html

¹² Valdes, J.M., (1996), *Culture Bound: Bridging the Cultural Gap in Language Teaching*. Cambridge University Press.

shok kulturor, apo në të kundërt një lloj venerimi deri në pikën e heqjes dorë nga identiteti kulturor i gjuhës amtare.

Ky lloj refuzimi apo shoku kulturor ndodh atëherë kur përballja me një aspekt kulturor është kaq e menjëhershme dhe kaq e ndryshme nga ajo që ne njohim ose pranojmë saqë goditja psikologjike është e atij niveli të fortë që sjell si rrjedhojë mospranueshmërinë dhe refuzimin total për ta njohur atë aspekt.

Kështu, nëse do t'i riktheheshin edhe njëherë periudhës së pandemisë, kur u hamendësua që virusi nuk ishte prodhim i një laboratorit në Wuhan por shkak - rrjedhojë e ushqyerjes me lakuriqë nate, e pamendueshme për një pjesë të mirë të botës, kinezët u anatemuuan dhe u neveritën për shkak të mënyrës së tyre të ushqyerjes. Sigurisht, që kjo lloj ushqyerjeje do të ishte thjesht e papranueshme në kushte të tjera, por në kushtet e pandemisë ajo u kthye në objekt sulmi dhe denigrimi. Kjo përbën një shembull të qartë se si një aspekt kulturor i një kombi trajtohet si denigrim i qenies njerëzore dhe mospranimi bëhet real, i dukshëm madje i dhunshëm duke sjellë përbuzje dhe neveri shoqërore ndaj një kombi.

Ndaj në mësimin e kulturës së një gjuhe të huaj mësuesi i asaj gjuhe duhet të mundësojë realizimin e relativizmit kulturor, të pranimi të tjetrit dhe diversiteti të tij ose quajtur ndryshe distanca sociale ndërmjet dy kulturave.¹²

Kjo do të thotë pranimin e një larmie modelesh, në kuptimin që secili është më i miri për atë kulturë, secili është shprehja e një populli, atë që Freddi e ka përcaktuar si «relativizëm kulturor». *Sipas këtij parimi, nuk ka kulturë që është më e mirë se një tjetër, por secila përfaqëson plotësisht një popull.*¹³

Ky është një nga objektivat më të rëndësishëm që synon njohja e një kulture të huaj. Realizmi i këtij objektivi mundësohet duke reduktuar “distanca sociale” që ekzistojnë ndërmjet dy gjuhëve dhe dy kulturave, sepse sa më e madhe të jetë kjo distancë aq më i vështirë do të jetë mësimi i gjuhës dhe kulturës së asaj gjuhe. Reduktimi i kësaj distance kërkon nga mësuesi përkushtim, njohje të mirë të modeleve kulturore të asaj gjuhe, shmangien e stereotipave dhe ofrimin e

¹³ Freddi G., (1995), *Didattica delle Lingue Moderne*, Minerva Italica.

modeleve kulturore autentike që i mundësojnë nxënësit të njohë qartësisht dhe realisht një aspekt kulturor.

Mësuesi ka për detyrë që në krahasimin ndërmjet dy kulturave të gjejë pikat e përbashkëta që mund t'i lidhin ato si dhe dallimet ndërmjet tyre. Në këtë lloj përjasje atij i duhet të jetë asnjans dhe të ofrojë sqarime pa denigruar dhe pa lartësuar një kulturë në krahasim me tjetrën.

Gjithashtu një faktor i rëndësishëm në njohjen e një kulture ka motivimi. Të motivosh do të thotë të nxisësh për të arritur qëllimin dhe objektivat lidhur në këtë rast me njohjen e gjuhës së huaj.

Por çfarë lloj motivimi duhet të kemi parasysh në mësimin e një gjuhe dhe kulture të huaj. Balboni¹⁴, e ndan analizën e motivimit në tre makro-kategori bazë:

- Motivim i bazuar në detyrim, pra, detyrimi për të mësuar (për shembull në mjedisin shkollor), i cili, nëse nuk mbështetet nga interesi efektiv, prodhon të mësuar, por jo përvetësim: përmbajtjet në fakt ruhen në kujtesën afatshkurtër dhe harrohen shpejt.
- Motivim i bazuar tek nevoja, motivimi i lidhur me hemisferën e majtë cerebrale, në të cilën nxënësi është i vetëdijshëm në mënyrë racionale për nevojën për të zhvilluar njohuri specifike për të arritur një qëllim.
- Motivimi i bazuar tek kënaqësia, “një motivim i lidhur në thelb me hemisferën e djathtë të trurit, por që mund të përfshijë edhe të majtën, duke u bërë kështu shumë i fuqishëm”

Sigurisht që është e qartë që motivimi i bazuar në detyrim nuk gjeneron nxënie dhe humbet në kohë, ndaj dy format e tjera të motivimit janë ato që mbështesin nxënien. Por ndërsa motivi i bazuar tek nevoja është i lidhur më tepër me karrierën profesionale apo mbijetesën dhe integrimin në një shoqëri të huaj për një të rritur, kjo nuk mund të jetë shumë e vlefshme për fëmijët dhe adoleshentët, tek të cilët nxënia duhet të bazohet edhe në kënaqësinë që ata përjetojnë. Ndaj dhe mësimdhënia duhet të bazohet më shumë në këto lloj motivimesh.

¹⁴ Balboni, P. E. (2002) *Le sfide di Babele*, Utet, Torino, fq 37.

- Si mundësohet kjo?
- Mësuesi duhet para së gjithash të ketë një formim të mirë psiko - pedagogjiko- didaktik, të tillë që i mundëson njohjen e thellë të proceseve të nxënies në të gjitha aspektet që nxënia përfshin tek individit në një moshë dhe nivel të caktuar, me qëllim që të përdorë teknika dhe strategji të tilla të mësimdhënies që mundësojnë arritjen e objektivave.
- Të ofrojë modele kulturore autentike të përshtatura me interesin, moshën dhe nivelin e studentit.
- Të dijë të trajtojë me kujdes aspektet kulturore të huaja duke ofruar shpjegimet përkatëse me karakter njohës, të tilla që i mundësojnë studentit njohje dhe pranim të diversitetit të tyre.

Siç dhe e shohim qartë roli i mësuesit në mësimdhënien e kulturës së një gjuhe të huaj është mjaft i rëndësishëm dhe ai është një pikë e fortë referimi ku nxënësi gjen informacionin dhe shpjegimin e duhur lidhur me paqartësitë dhe vështirësitë që mund të hasë.

5. Përfundime

Për sa më sipër mund të themi që mësimdhënia e një kulture të huaj është një faktor mjaft i rëndësishëm në formimin e duhur të individit në një gjuhë të huaj me qëllim realizmin e tij si individ në të ardhmen lidhur me përdorimin dhe komunikimin e atij individit në një gjuhë të huaj. Njohja e një kulture të huaj e përfshin individin jo vetëm në konceptin gjuhësor por edhe në atë genësor si individ.

BIBLIOGRAFIA

- Balboni P.E. (1994), *“Didattica dell’italiano a stranieri”*, Bonacci editore, Roma.
- Balboni, P. E. (2002), *Le sfide di Babele*, Utet, Torino.
- Boas, Franz 1964 [1911]. *Questioni fondamentali dell’antropologia culturale* [*The mind of primitive man*]. Buenos Aires: Solar/Hachette
- Freddi G., (1995), *Didattica delle Lingue Moderne*, Minerva Italica.
- Giaccardi C. (2005), *La comunicazione interculturale*, Mulino
- Greimas, A. J. (1970). *Les proverbes et les dictons*. Du sens,1.

- Harrison K. D. (2010), *The Last Speakers: The Quest to Save the World's Most Endangered Languages*, National Geographic.
- Mencarelli, M., (1970), *La struttura del discorso pedagogico*, Pro-Manuscripto, Arezzo.
- Nasir, N., Hand, V. (2006). *Exploring sociocultural perspectives on race, culture, and learning*. Review of Educational Research, 76. Qarkore Minstrisë (1990) https://www.edscuola.it/archivio/norme/circolari/cm205_90.html
- Sapir, E. (1921). *Language*. New York: Harcourt Brace.
- Valdes, J.M., (1996), *Culture Bound: Bridging the Cultural Gap in Language Teaching*. Cambridge University Press.
- Whorf, B. L. (1956), *Language, Thought, and Reality: Selected Writings of Benjamin Lee whorf*, John B. Carroll (ed.), ed., MIT Press.